



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
BIOLOGJI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE

VENDI

KOMUNA


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 170620260827

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuar.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR
TESTI
BIOLOGJI

1. Në orën e biologjisë Jehona i ka shpjeguar në lojën e asociacioneve tiparet e një grupi organizmash. Organizmat të cilët i përshkroi si njëqelizorë dhe pa bërthamë. Disa lloje mund të shkaktojnë sëmundje, por ka edhe të dobishëm për njeriun dhe natyrën.
Cili grup i organizmave është përshkruar?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ bakteret ☐ algat ☐ kërpudhat ☐ bimët
2. Cila molekulë mund të gjendet në të gjithë organizmat e gjallë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ celuloza ☐ amidoni ☐ ADN ☐ klorofili
3. Cili organel ia mundson bimëve mënyrën autotrofe të ushqimit?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ vakuola ☐ mitokondria ☐ kloroplasti ☐ bërthama
4. Kush ia siguron patave energjinë për të notuar?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ pendët e shpeshta
- ☐ lëvizja e krahëve
- ☐ membranat notuese
- ☐ ushqimi me krimba
5. Sa kromozome i përmban qeliza vezë e femrave?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ 2 ☐ 22 ☐ 23 ☐ 46
6. Në një arë insekti që ka aromë të keqe ushqehet me lëngun e gjetheve të reja të misrit. Cilat nga këto insekte mund të presim që janë në numër më të madh prezente aty?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ kafe e mbyllët ☐ e kuqe në të zezë
- ☐ e gjelbërt ☐ portokall në të zezë

7. Peshqit e rrjedhës së epërme të lumit kanë trup hidrodinamik, të fortë dhe muskular. Cili faktor ka ndikuar që të zhvillohen këto adaptime?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ temperatura e ajrit ☐ sasia e dritës
- ☐ sasia e kripës ☐ shpejtësia e rrjedhës së ujit
8. Cilat lloje bimore e banojnë vetëm Gadishullin Ballkanik dhe nuk i gjejmë në asnjë vend tjetër të botës?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Pisha e bardhë ☐ Pisha e zezë
- ☐ Molika e Pançiqit ☐ Bredhi
9. Cila sëmundje mund të transmetohet me rrugë seksuale nëse nuk përdoret prezervativ?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Sifilizi ☐ Salmonella
- ☐ Konjuktivitisi ☐ Skleroza multiple
10. Nga çka dallon bretkoca nga bliri?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Kalon nëpër metamorfozë gjatë zhvillimit
- ☐ Reagon në ngacmimet nga mjedisi i jashtëm
- ☐ E kryen shkëmbimin e gazrave
- ☐ Shumohet në mënyrë seksuale
11. Lulëzimi i ujit është pasojë e koncentrimit të lartë të materieve organike dhe temperaturave në mjediset ujore. Cilat organizma e kanë bërë të mundur shfaqjen e kësaj dukurie?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ algat ☐ kërpudhat ☐ bimët ☐ shtazët
12. Cilat bimë e thithin ujin nga mjedisi pa praninë e rrënjëve?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ pisha e zezë
- ☐ bozhuri i stepeve
- ☐ myshqet e ngjeshur
- ☐ fieri

13. Shpezët e Darvinit nga pjesa më e poshtme e Amerikës Jugore janë shpërndarë në ishujt përreth dhe pas një kohe janë vërejtur ndryshime në madhësinë dhe formën e sqepit të tyre ndërmjet llojeve gjeografikisht të largëta. Cilat kushte në ishujt e afërt kanë sjellë deri te lindja e shpezëve të ndryshëm? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ rrymat e forta detare
- ☐ ndikimi i njeriut
- ☐ burimi i ushqimit
- ☐ armiqtë e natyrës

14. Ngjyros rrethin në fushën ashtu që të renditësh llojet në popullatë në varësi nga resurset e pranishme.

	Ndarja grupore	Ndarja e drejtë	Ndarja e rastësishme
Lulerradhiqja në livadhe	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Luledielli në arë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Tufa e peshqve në det	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

15. Nderimi gjatë pushimeve ka shkuar me prindërit në një udhëtim. Ia ka treguar shokëve të klasës fotografitë e udhëtimit. Në një nga fotografitë duket një barë i lartë, një dru i vetmuar, zebra dhe antilopa. Cili biom është paraqitur në këtë fotografi? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ tundra ☐ tajga ☐ stepe ☐ savane


16. Ushqimi i pasur me qime përmban celulozë të cilën trupi ynë nuk mund ta zbërthejë. Megjithatë ajo e zvogëlon rrezikun nga sëmundjet e zorrëve. Cilin ushqim duhet ta konsumojmë më shumë ashtu që organizmi ta plotësojë nevojën për qime? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ peshku ☐ mishi ☐ perime ☐ qumësht

17. Shpezët mundën për një kohë të shkurtër të marrin një sasi të madhe të ushqimit. Si quhet pjesa e sistemit të organeve të tretje së shpendëve në të cilin ushqimi grumbullohet dhe zbutet? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ vrima e gojës ☐ lukthi ☐ gusha ☐ kloaka

18. Në fotografi është paraqitur skema e Mejozës.



Ngjyros rrethin në fushat përkatëse ashtu që të lidhësh qelizat me numrin e kromozomeve.

	qelizat diploide (2n)	qelizat haploide (n)
qeliza 1	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
qeliza 2	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
qeliza 3	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

19. Ngjyros rrethin në fushën përkatëse ashtu që të lidhësh ndikimin e adrenalinës në aktivitetin e këtyre organeve.

ngushton bronket	zmadhon bebëzat	ul shtypjen e lartë të gjakut	shpejton punën e zemrës	rrit nivelin e sheqerit në gjak
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

20. Në ekosistem qeniet e gjalla shkëmbejnë energjinë dhe substancat e tjera. Cili pohim e pasqyron këtë proces?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ Sasia e energjisë së përgjithshme të qenieve të gjalla rritet në secilin nivel trofik.
- ☐ Në ekosistem energjia qarkullon, substanca rrjedh.
- ☐ Secila piramidë ushqyese fillon me bimëngrënësit.
- ☐ Në ekosistem energjia rrjedh, substanca qarkullon.

FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
BIOLOGJI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE
VENDI
KOMUNA

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR